

Thirrje për ekspertë dhe staf për integrimin e perspektivës gjinore

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) po mbledhë një grup ekspertësh që do të jenë të interesuar të punojnë me RrGK në të ardhmen, si konsulentë ose staf. Detyrat kryesore do të lidheshin me: integrimi i perspektivës gjinore në ligje, politika dhe dokumente të projektit; ofrimi i trajnimeve dhe mentorimeve; dhe ndërmarrja e veprimeve për ndërgjegjësimin dhe avokimin në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE).

Aplikantët duhet të posedojnë së paku:

- Njohuri bazike të terminologjisë dhe koncepteve në lidhje me barazinë gjinore;
- Interes për integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE;
- Aftësi të forta analitike / të të menduarit kritik; dhe
- Aftësi të shkëlqyeshme në të shkruar në anglisht.

Preferohet por nuk kërkohet domosdo:

- Njohuri mbi BE dhe funksionimin e saj;
- Përvojë në integrimin e perspektivës gjinore në dokumente;
- Njohuri për kornizat logjike (logjika e ndërhyrjes);
- Aftësi / përvojë në hulumtime cilësore ose sasiore;
- Përvojë në avokim tek institucionet; dhe
- Përvojë në ofrimin e trajnimeve ose mentorimeve lidhur me barazinë gjinore.

Kandidatët e interesuar inkurajohen të dërgojnë CV-në e tyre dhe një letër motivimi në jobs@womensnetwork.org deri më **13 shkurt**, me titull “**Integrimi i perspektivës gjinore**”.

E rëndësishme: Finalistët duhet të marrin pjesë në një punëtori në RrGK më **22 shkurt** në lidhje me integrimin e një perspektive gjinore në dokumente, gjatë së cilës do t'u kërkohet të përgatisin një mostër të shkurtër të punës së tyre që rezulton nga punëtorja. Bazuar në këtë, RrGK do të zgjedh grupin e ekspertëve. Njohuritë paraprake inkurajohen, por nuk kërkohen, pasi RrGK do të sigurojë informacione gjatë punëtorisë për të gjithë kandidatët e listës së ngushtë. Nga këta kandidatë, RrGK gjithashtu do të zgjedhë një Koordinator/e të Projektit me orar të plotë për të punuar në integrimin e perspektivës gjinore në procesin e anëtarësimit në BE të Kosovës dhe rajonit. Kandidatët e interesuar duhet të shënojnë interesin e tyre për secilën nga këto pozita në letrën motivuese.